

## Raport Monitorimi

### i Bashkisë Tiranë për 8-mujorin 2021

---

# HYRJE

---

Bazuar në ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë’ (i ndryshuar), Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2016 për ‘Vetëqeverisjen Vendore’, ligjit nr. 68 date 27.04.2017 ‘ Për Financat e vetëqeverisjes vendore’, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 9, datë 20.03.2018 ‘Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit’; udhëzimit plotësues nr.4 datë 25.01.2021 të Ministrisë së Financave ‘Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021’; Udhëzimit nr.22 dt 30.07.2018 ‘Për procedurat standarte të Monitorimit të buxhetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore’; VKB nr. 172 datë 21.12.2020 ‘Për miratimin e PBA 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2021,(i ndryshuar), paraqesim raportin e monitorimit të buxhetit për 8-mujorin 2021, duke analizuar performancën financiare në funksion të arritjes së objektivave dhe realizimit të shpenzimeve sipas programeve.

Raporti bazohet në të dhënat për të ardhurat dhe shpenzimet faktike dhe transfertat ndërqeveritare, duke ndjekur klasifikimin administrativ, ekonomik, funksional dhe sipas burimeve të financimit.

Transparenca mbi përdorimin e fondeve publike është e rëndësishme për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, ndërgjegjësimin dhe aktivizimin e qytetarëve në vendimmarrje dhe rritjen e përgjegjshmërisë së të zgjedhurve ndaj qytetarëve. Tashme që nga viti 2015 zbatohet Reforma Administrative dhe Territoriale (RAT) dhe decentralizimit të funksioneve të reja.

Në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë’, me VKB nr.51 datë 06.04.2021 të ardhurat e papërdorura të vitit buxhetor 2020 trashëgohen në buxhetin e vitit 2021.

Realizimi i shërbimeve në përputhje me standartet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative, referuar situatës së krijuar në fund të vitit 2020, ku nuk patëm limitim të përdorimit të cashi-t, Bashkia Tiranë vijoi me likuidimet e angazhimeve të marra edhe pas miratimit të Buxhetit të vitit 2021 edhe gjatë Dhjetorit 2020, kjo situatë gjatë 8-mujorit të 2021 solli nevojat për rishikime të planifikimeve të shumë investimeve të cilat ndryshe u miratuan në PBA 2021–2023 dhe ndryshe u reflektuan pas pagesave në fund të vitit. Gjithsesi vijon evidentimi dhe kërkesat për përfshirje në buxhet të detyrimeve të prapambetura nga viti 2020.

Nga ana tjetër dinamika me të cilën ecin punët në Bashkinë Tiranë kërkon jo vetëm rishikime të projekteve në vazhdim, por edhe kërkesa për të shtuar projekte dhe shpenzime të reja për të maksimizuar nevojat e Institucionit në funksion të qytetit.

# PJESA I

## *Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2021*

Bashkia Tiranë gjatë kesaj periudhe, ka menaxhuar dhe realizuar shpenzime sipas 27 programeve buxhetore, bazuar në funksionet bazë dhe të deleguara sipas ligjit për qeverisjen vendore, konkretisht:

1. Programi Planifikim, Menaxhim & Administrim
2. Programi Ceshtje Financiare & Fiskale
3. Programi Sherbimet e Policise Vendore
4. Programi Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile
5. Programi Mbeshtetja per Zhvillimin Ekonomik
6. Programi Sherbimi i Tregjeve, Akreditimi & Inspektimi
7. Programi Sherbimet Bujqesore, Inspektimi, Siguria Ushq & Mbrojtja e Konsumat
8. Programi Menaxhim I Infrastruktures se Ujitjes & Kullimit
9. Programi Administrimi I Pyjeve & Kullotave
10. Programi Rrjeti Rrugor
11. Programi Transporti Publik
12. Programi Projekte Zhvillimi
13. Programi Zhvillimi i Turizmit
14. Programi Menaxhim i Mbetjeve
15. Programi Strehimi Lokal & Urbanistika
16. Programi Programet e Zhvillimit
17. Programi Sherbimet Publike Vendore
18. Programi Ndricim Rrugesh
19. Programi Sport dhe Argetim
20. Programi Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore
21. Programi Arsimi Baze perfshire arsimin parashkollor
22. Programi Arsimi i Mesem i Pergjithshem
23. Programi Arsimi Profesional
24. Programi Kujdesi Social per personat e semure & me aftesi te kufizuar
25. Programi Kujdesi Social per familjet & femijet
26. Programi Papunesia, Arsim & Aftesim Profesional
27. Programi Strehim Social

Buxheti fillestar i Bashkisë Tiranë për vitin 2021 është 20,533,367,583 lekë. Kjo vlerë përfshin të Ardhurat e veta të Bashkisë Tirane dhe Transferten e Pakushtezuar.

Gjate 8-mujorit të vitit 2021 kemi pasur rishikim të buxhetit me 6 (gjashtë) vendime të Këshillit Bashkiak dhe një Urdhër Kryetari :

Me VKB shtesa e fondit të mbartur nga viti 2020. Referuar ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” si dhe Udhëzimit Plotësues “Për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2020”, ku të ardhurat e papërdorura të një viti buxhetor trashëgohen në vitin pasardhës, duke mbajtur në konsideratë që Akt-rakordimet me Degën së Thesarit kryhen pas miratimit të buxhetit nga Këshilli Bashkiak.

Referuar Akt-rakordimeve përfundimtare fondi i mbartur në total është në vlerën 2,793,430,805 lekë i përbërë: nga të ardhurat e mbartura dhe të papërdorura 1,825,588,463 lekë; nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale e përgjithshme në shumën 909,900,174 lekë. Ndërsa vlera e fondeve të mbartura nga donatorët është në shumën 57,942,168 lekë.

Bashkia Tiranë në vazhdimësi të ndihmesës së ofruar sektorit të njësive të shërbimit dhe më specifikisht biznesit të vogël, ka propozuar përjashtimin nga pagesa e detyrimit të tarifës së zënies së hapësirës publike për 6 muaj për periudhën prill 2021 – shtator 2021, si pjesa më e prekur, si pasojë e vazhdimit të situatës së krijuar nga pandemia Covid 19 dhe faktin që këto lloj aktivitete vazhdojnë të kenë kufizime në zhvillimin e aktivitetit në ambiente të mbyllura. Kjo situatë vazhdon për shkak të kufizimeve nga mungesa e qarkullimit të lirë të qytetarëve nga shtetet e BE.

Buxheti i rishikuar i Bashkisë Tiranë për vitin 2021 është 38,625,657,471 lekë. Kjo vlerë përfshin të gjitha burimet e financimit.

## **1. Ceshtje te rishperndarjes se buxhetit gjate periudhes**

- Përfshirja e kërkesave dhe e detyrimeve të krijuara rishtazi në buxhetin e vitit 2021, për aparatet e Bashkisë si dhe për të gjitha institucionet e varësisë së Bashkisë së Tiranës, si dhe sistemet në zërat e investimeve duke sjellë si rezultat shtesa, pakësime apo rishpërndarje fondesh si rezultat i dinamikes pas hapjes nga periudha e pandemisë.

- Fondet e trashëguara të rindërtimit nga viti 2020 përdoren për të njëjtin qëllim për të cilin janë akorduar bazuar në VKM-të e vitit 2020 si rindërtimi i objekteve arsimore, rindërtimi i banesave individuale, rindërtimi i infrastrukturës publike, rindërtimi i njësive të banimit ndërtesa (pallat) zona 5 Maji Kombinat, hartim i planeve të detajuara vendore, inspektim vlerësim dëmsh, hartim projekti të ndërhyrjeve rehabilituese si dhe Shpronësim Zhvillimi i Njesisë Administrative Vaqarr.

- Nevoja e dyfishimit të masës së ndihmës ekonomike të shkaktuara nga epidemia COVID-19.

- Ndryshim në zërin buxhetor duke qenë se mësimi u zhvillua më së shumti online u bë i pamundur zbatimi i këtij projekti për vitin shkollor 2020-2021, duke shtuar vlerën e planifikuar buxhetore në zërin “Sipërmarrja ime për shkollën”

- Zmadhim të kapitalit për shpenzimet dhe investimet e shoqërisë Tiranë Agrikulturë për vitin 2021, duke qenë se kjo shoqëri mendohet të konsolidohet duke gjeneruar të ardhura të mjaftueshme mujore duke përballuar shpenzimet për paga, shpenzime operative etj.

- Fond shtesë për të likuiduar detyrime të prapambetura për vitin shkollor 2019-2020 për nxënësit me 10-ta për arritje të shkëlqyera. Mësimi online si rezultat i pandemisë solli një rritje në numrin e nxënësve, e pamundur të parashikohej në fillim viti.

- Kërkesë për garantim të fondeve financiare për shpronësim për objekte publike.

- Përfshirja e kërkesës për shtim të fondeve për shpenzimeve operative të nevojshme për dezinfektim. Kërkesa për shlyerje detyrimesh të prapambetura dhe shpenzime të ndricimit të qytetit, për blerje materiale bitum, karburant lëndë djegëse etj. Kërkesë për mjete transporti.


- Nevoja për parandalimin e fatkeqësive si emergjence dhe fondi i pamamjaftueshëm, solli rialokim të fondeve

- Përfshirja e kërkesës për përmirësimin e kushteve dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve ofruar për shtetas në nevojë në Qendrën Komunitare Shkozë.

- Nga Drejtorite e Përgjithshme janë paraqitur kërkesa për rialokime në buxhetin e vitit 2021 kryesisht në shtim plani për shpenzime operative, ndryshime emërtimesh, investime të reja, studim projektive dhe oponenta për objekte të reja ndërtimore etj.

- **Shpenzimet sipas programeve**

Buxheti i Bashkisë Tiranë i ndarë sipas programeve paraqitet si vijon:



Sic vihet re, peshën më të madhe në planifikim e zënë:

- Programi i Arsimit Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor (13%)
- Programet e Zhvillimit (11.4%)
- Programi i Shërbime Publike Vendore (10.4%)
- Programi i Strehim Lokal dhe Urbanistika (9.8%)
- Programi i Planifikim, Menaxhim & Administrim (8.9%)

- **Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik**

Në total Bashkia Tiranë ka një realizim prej 47% të planit 8-mujor 2021.

Referuar klasifikimit ekonomik realizimi paraqitet si më poshtë:

- shpenzimet e personelit janë realizuar 85%,
- shpenzimet operative 61%
- shpenzimet kapitale 29%.

Më poshtë paraqitet në mënyrë tabelare informacioni i mësipërm:

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2021	Plani 8M 2021	Fakti 8M 2021	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	6,634,423,570	4,559,562,856	3,861,226,509	85%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	13,434,127,936	11,637,484,067	7,048,347,618	61%
<i>Shpenzime kapitale</i>	18,557,105,965	17,443,954,083	4,976,962,564	29%
<b>Totali</b>	<b>38,625,657,471</b>	<b>33,641,001,006</b>	<b>15,886,536,691</b>	<b>47%</b>


- **Shpenzimet sipas burimeve të financimit**

Shpenzimet sipas Burimeve të financimit për 8-mujorin 2021, paraqiten si më poshtë:

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2021	Plani 8M 2021	Fakti 8M 2021	Realizimi ne %	struktura vjetore
<i>Te ardhura BT</i>	18,441,024,463	14,238,540,067	7,227,717,059	51%	48%
<i>Transferta e Pakushtezuar +Sektoriale</i>	4,770,072,562	3,989,267,825	2,038,078,394	51%	12%
<i>Transferta e Pakushtezuar Rindertimi</i>	11,339,847,475	11,339,847,475	3,863,600,296	34%	29%
<i>Transferta e Kushtezuar</i>	3,950,773,891	3,949,406,559	2,727,453,419	69%	10%
<i>Donacione</i>	80,235,374	80,235,374	27,393,813	34%	0%
<i>Financime te Huaja</i>	43,703,706	43,703,706	2,293,710		0%
<b>Totali</b>	<b>38,625,657,471</b>	<b>33,641,001,006</b>	<b>15,886,536,691</b>	<b>47%</b>	<b>100%</b>

Sikurse vërehet edhe në tabelën e mësipërme , burimi kryesor i financimit për buxhetin e 8-mujorin 2021 vijon të jetë nga të ardhurat e Bashkisë, në vlerën faktike 7,227,717,059 lekë e cila përbën 45% të të ardhurave totale faktike.

Fondet e Pakushtëzuara & Sektoriale zënë 12% të burimeve të financimit të planifikuara, Fondet e Pakushtëzuara Rindertimi zene 29% të burimeve të financimit të planifikuara, Fondet e Kushtëzuara zënë 10% të strukturës së burimeve të financimit, sipas grafikut me poshte.




- **Shpenzimet sipas klasifikimit në programe**

Tabela më poshtë paraqet shpërndarjen e shpenzimeve të 8-mujorit 2021 në bazë programesh.

Emertimi	Plan 2021	Plani 8-M 2021	Fakti 8-M 2021	%
<i>Planifikim, Menaxhim &amp; Administrim</i>	3,424,857,938	2,491,525,084	1,675,403,175	49%
<i>Ceshtje Financiare &amp; Fiskale</i>	343,151,000	234,790,000	193,154,082	56%
<i>Sherbimet e Policise Vendore</i>	517,675,300	351,431,000	323,337,756	62%
<i>Mbrojtja nga Zjarri &amp; Mbrojtja Civile</i>	3,060,636,173	2,896,241,666	963,115,011	31%
<i>Mbeshtetja per Zhvillimin Ekonomik</i>	73,000,000	69,000,000	41,369,609	57%
<i>Sherbimi I Tregjeve, Akreditimi &amp; Inspektimi</i>	75,912,100	53,751,300	43,992,275	58%
<i>Inspektimi, Siguria Ushqimore &amp; Mbrojtja e Konsumatoreve</i>	316,959,934	228,810,934	165,812,119	52%
<i>Menaxhim I Infrastruktures se Ujitjes &amp; Kullimit</i>	57,072,907	16,982,706	4,958,393	9%
<i>Administrimi I Pyjeve &amp; Kullotave</i>	10,642,664	8,452,551	4,561,979	43%
<i>Rrjeti Rrugor</i>	2,327,407,351	1,981,896,260	814,434,088	35%
<i>Transporti Publik</i>	346,434,258	241,189,122	109,487,762	32%
<i>Projekte Zhvillimi</i>	129,445,615	118,553,706	35,001,950	27%
<i>Zhvillimi I Turizmit</i>	18,837,945	14,837,945	400,000	2%
<i>Menaxhim I Mbetjeve</i>	3,062,314,180	2,676,403,867	1,699,706,414	56%
<i>Strehimi Lokal &amp; Urbanistika</i>	3,790,542,746	3,050,114,233	1,148,405,067	30%
<i>Programet e Zhvillimit</i>	4,396,576,218	4,381,576,218	1,508,634,013	34%
<i>Sherbimet Publike Vendore</i>	4,010,761,368	3,446,076,208	1,734,395,305	43%
<i>Ndricim Rrugesh</i>	386,305,357	283,805,357	151,645,953	39%
<i>Sport dhe Argetim</i>	294,697,156	230,300,343	154,167,726	52%
<i>Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike &amp; Kulturore</i>	1,072,300,740	997,891,940	189,059,503	18%
<i>Arsimi baze perfshire arsimin parashkollor</i>	5,059,146,028	4,488,293,252	1,638,153,580	32%
<i>Arsimi I mesem I pergjithshem</i>	2,889,057,230	2,539,662,340	954,713,921	33%
<i>Arsimi profesional</i>	207,240,369	180,154,080	83,525,311	40%
<i>Kujdesi Social per personat e semure &amp; me aftesi te kufizuar</i>	18,960,000	13,500,000	9,856,500	52%
<i>Kujdesi Social per familjet &amp; femijet</i>	2,543,922,894	2,464,560,894	2,198,745,039	86%
<i>Papunesia, Arsim &amp; Aftesim profesional</i>	25,000,000	15,000,000	-	0%
<i>Strehim Social</i>	166,800,000	166,200,000	40,500,160	24%
<b>TOTAL</b>	<b>38,625,657,471</b>	<b>33,641,001,006</b>	<b>15,886,536,691</b>	<b>41%</b>

## Buxheti sipas programeve



- Planifikim, Menaxhim & Administrim
- Ceshtje Financiare & Fiskale
- Sherbimet e Policise Vendore
- Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile
- Mbeshtetja per Zhvillimin Ekonomik
- Sherbimi I Tregjeve, Akreditimi & Inspektimi
- Sherbimet Bujqesore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatoreve
- Menaxhim I Infrastruktures se Ujitjes & Kullimit
- Administrimi I Pyjeve & Kullotave
- Rrjeti Rrugor
- Transporti Publik
- Projekte Zhvillimi
- Zhvillimi I Turizmit
- Menaxhim I Mbetjeve
- Strehimi Lokal & Urbanistika
- Programet e Zhvillimit
- Sherbimet Publike Vendore
- Ndricim Rrugesh
- Sport dhe Argetim
- Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore
- Arsimi baze perfshire arsimin parashkollor
- Arsimi I mesem I pergjithshem
- Arsimi profesional
- Kujdesi Social per personat e semure & me aftesi te kufizuar
- Kujdesi Social per familjet & femijet
- Papunesia, Arsim & Aftesim profesional

-**Programi i Arsim Baze dhe Parashkollor** i cili përbën 13% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 36% të 8-mujorit 2021

- **Programet e Zhvillimit** i cili përbën 11.4% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 34% të 4-mujorit 2021.



- **Programi i Shërbimeve Publike Vendore** i cili përbën 10.4% të buxhetit vjetor dhe ka një realizim në masën 50% të 8-mujorit 2021

-**Programi i Strehimit Lokal dhe Urbanistika** i cili përbën 9.8% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 38% të 8-mujorit 2021.

-**Programi Planifikim, Menaxhim, Administrim** i cili përbën 8.9% të buxhetit vjetor dhe ka një realizim në masën 67% të 8-mujorit 2021

- **Shpenzimet sipas programeve dhe klasifikimit ekonomik**

Shpenzimet korente dhe kapitale për çdo funksion sipas programeve dhe nga të gjitha burimet pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Emertimi	SHPENZIME KORENTE			SHPENZIME KAPITALE		
	Plan 8M 2021	Fakti 8M 2021	%	Plan 8M 2021	Fakti 8M 2021	%
<i>Planifikim, Menaxhim &amp; Administrim</i>	2,239,140,788	1,610,538,856	72%	252,384,296	64,864,319	26%
<i>Ceshtje Financiare &amp; Fiskale</i>	203,000,000	193,154,082	95%	31,790,000	-	
<i>Sherbimet e Policise Vendore</i>	348,011,000	322,779,756	93%	3,420,000	558,000	16%
<i>Mbrojtja nga Zjarri &amp; Mbrojtja Civile</i>	2,705,383,840	939,987,905	35%	190,857,826	23,127,106	12%
<i>Mbeshtetja per Zhvillimin Ekonomik</i>	69,000,000	41,369,609	60%			
<i>Sherbimi I Tregjeve, Akreditimi &amp; Inspektimi</i>	43,676,000	39,132,275	90%	10,075,300	4,860,000	48%
<i>Sherbimet Bujqesore, Inspektimi, Siguria Ushqimore &amp; Mbrojtja e Konsumatoreve</i>	215,560,934	158,624,941	74%	13,250,000	7,187,178	54%
<i>Menaxhim I Infrastruktures se Ujitjes &amp; Kullimit</i>	16,982,706	4,958,393	29%			
<i>Administrimi I Pyjeve &amp; Kullotave</i>	8,452,551	4,561,979	54%			
<i>Rrjeti Rrugor</i>	653,435,107	419,429,180	64%	1,328,461,153	395,004,908	30%
<i>Transporti Publik</i>	138,849,122	94,495,149	68%	102,340,000	14,992,613	15%
<i>Projekte Zhvillimi</i>	340,000	-	0%	118,213,706	35,001,950	30%
<i>Zhvillimi I Turizmit</i>	14,837,945	400,000	3%			
<i>Menaxhim I Mbetjeve</i>	2,676,403,867	1,699,706,414	64%			
<i>Strehimi Lokal &amp; Urbanistika</i>	147,500,000	98,007,320	66%	2,902,614,233	1,050,397,747	36%
<i>Programet e Zhvillimit</i>	52,408,832	38,921,391	74%	4,329,167,386	1,469,712,622	34%
<i>Sherbimet Publike Vendore</i>	821,695,800	736,359,539	90%	2,624,380,408	998,035,766	38%
<i>Ndricim Rrugesh</i>	283,805,357	151,645,953	53%			
<i>Sport dhe Argetim</i>	213,185,343	149,933,508	70%	17,115,000	4,234,218	25%
<i>Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike &amp; Kulturore</i>	359,208,343	189,049,336	53%	638,683,597	10,167	0%
<i>Arsimi baze perfshire arsimin parashkollor</i>	1,520,966,590	1,077,532,193	71%	2,967,326,662	560,621,387	19%
<i>Arsimi I mesem I pergjithshem</i>	799,403,515	637,638,224	80%	1,740,258,825	317,075,697	18%
<i>Arsimi profesional</i>	134,457,292	81,714,271	61%	45,696,788	1,811,040	4%
<i>Kujdesi Social per personat e semure &amp; me aftesi te kufizuar</i>	13,500,000	9,856,500	73%			
<i>Kujdesi Social per familjet &amp; femijet</i>	2,336,641,991	2,169,277,193	93%	127,918,903	29,467,846	23%
<i>Papunesia, Arsim &amp; Aftesim profesional</i>	15,000,000	-	0%			
<i>Strehim Social</i>	166,200,000	40,500,160	24%			
<b>TOTAL</b>	<b>16,197,046,923</b>	<b>10,909,574,127</b>	<b>67%</b>	<b>17,443,954,083</b>	<b>4,976,962,564</b>	<b>29%</b>

Në tabelën më poshtë paraqiten të dhënat duke iu referuar Programit Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2021-2023 të miratuar me VKB nr 172 date 21.12.2020 dhe në vazhdim, duke përfshirë të ardhurat e Bashkisë dhe transferet e pakushtezuar deri në periudhën 8-mujore 2021.

Emertimi	PBA 2021	Plan i rishikuar 2021	Plani 8-M 2021	Fakti 8-M 2021
<i>Planifikim, Menaxhim &amp; Administrim</i>	3,070,608,625	3,278,203,286	2,346,237,764	1,610,209,032
<i>Ceshtje Financiare &amp; Fiskale</i>	314,291,000	343,151,000	234,790,000	193,154,082
<i>Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm</i>				
<i>Sherbimet e Policisë Vendore</i>	510,904,300	517,675,300	351,431,000	323,337,756
<i>Mbrojtja nga Zjarri &amp; Mbrojtja Civile</i>	687,010,028	720,982,089	556,587,582	166,135,899
<i>Mbeshtetja për Zhvillimin Ekonomik</i>	73,000,000	73,000,000	69,000,000	41,369,609
<i>Sherbimi i Tregjeve, Akreditimi &amp; Inspektimi</i>	75,912,100	75,912,100	53,751,300	43,992,275
<i>Sherbimet Bujqesore, Inspektimi, Siguria Ushqimore &amp; Mbrojtja e Konsumatoreve</i>	283,100,725	316,959,934	228,810,934	165,812,119
<i>Menaxhim i Infrastruktura të Ujitjes &amp; Kullimit</i>	21,640,493	57,072,907	16,982,706	4,958,393
<i>Administrimi i Pyjeve &amp; Kullotave</i>	9,955,060	10,642,664	8,452,551	4,561,979
<i>Rrjeti Rrugor</i>	2,159,707,181	2,327,407,351	1,981,896,260	814,434,088
<i>Transporti Publik</i>	361,875,136	346,434,258	241,189,122	109,487,762
<i>Projekte Zhvillimi</i>	45,891,909	101,441,909	90,550,000	35,000,000
<i>Zhvillimi i Turizmit</i>	15,000,000	18,837,945	14,837,945	400,000
<i>Menaxhim i Mbetjeve</i>	2,019,119,069	2,462,314,180	2,076,403,867	1,101,933,320
<i>Strehimi Lokal &amp; Urbanistika</i>	2,116,904,095	2,899,245,204	2,158,816,691	407,158,333
<i>Programet e Zhvillimit</i>	133,448,849	65,355,346	50,355,346	38,921,391
<i>Sherbimet Publike Vendore</i>	3,023,072,298	3,173,812,510	2,609,127,350	1,503,592,850
<i>Ndricim Rrugesh</i>	326,000,000	386,305,357	283,805,357	151,645,953
<i>Sport dhe Argetim</i>	251,270,386	280,197,156	215,800,343	154,167,726
<i>Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike &amp; Kulturore</i>	393,885,035	496,350,778	421,941,978	186,767,743
<i>Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor</i>	2,295,461,838	2,739,354,889	2,168,502,113	1,141,341,590
<i>Arsimi i mesëm i përgjithshëm</i>	1,763,433,613	1,839,023,037	1,489,628,147	824,614,260
<i>Arsimi profesional</i>	114,832,223	178,501,705	151,415,416	61,603,598
<i>Kujdesi Social për personat e sëmurë &amp; me aftësi të kufizuara</i>	18,960,000	18,960,000	13,500,000	9,856,500
<i>Kujdesi Social për familjet &amp; fëmijët</i>	258,083,620	292,156,120	212,794,120	130,839,035
<i>Papunesia, Arsim &amp; Aftësim profesional</i>	25,000,000	25,000,000	15,000,000	-
<i>Strehim Social</i>	165,000,000	166,800,000	166,200,000	40,500,160
<b>TOTAL</b>	<b>20,533,367,583</b>	<b>23,211,097,025</b>	<b>18,227,807,892</b>	<b>9,265,795,453</b>

Në tabelën më poshtë paraqiten fondet të transferuara gjatë kësaj periudhe për bashkinë Tiranë si rezultat i funksioneve të deleguara për këtë periudhë 8-mujor 2021. Këtu përfshihen fondet që janë deleguar nga qeverisja qendrore nëpërmjet ministrive të linjës për funksionet e deleguara për:

- Gjendjen Civile
- Qendrën Kombëtare të Biznesit

- Ndihmën Ekonomike
- Ndihmë për Personat me Aftësi të Kufizuar
- Kuota për shërbime të ndryshme sociale, Bursa
- Transferime
- Projekte te reja arsimore e kulturore

Emertimi	Plan 2021	Plani 8-M 2021	Fakti 8-M 2021	%
<i>Planifikim, Menaxhim &amp; Administrim</i>	91,087,330	89,719,998	64,752,582	71%
<i>Menaxhim I Mbetjeve</i>	600,000,000	600,000,000	597,773,094	100%
<i>Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike &amp; Kulturore</i>	560,249,962	560,249,962	-	0%
<i>Arsimi baze perfshire arsimin parashkollor</i>	69,197,379	69,197,379	25,375,992	37%
<i>Arsimi I mesem I pergjithshem</i>	502,230,000	502,230,000	401,393	0%
<i>Kujdesi Social per familjet &amp; femijet</i>	2,128,009,220	2,128,009,220	2,039,150,358	96%
<b>TOTAL</b>	<b>3,950,773,891</b>	<b>3,949,406,559</b>	<b>2,727,453,419</b>	<b>69%</b>

✓ Përdorimi i Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës

Fondi Rezervë per periudhën janar – gusht 2021, është përdor si mëposhtë:

VKB nr. 75 datë 09.06.2021 'Për dhënien e ndihmës financiare, nga Bashkia e Tiranës për komunën e Preshevës, me qëllim lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet masive', në shumën 6,153,500 lekë.

VKB nr.96 datë 02.08.2021 'Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Galerisë së Artit, Tiranë', në shumën 5,500,000 lekë.

Gjendja e fondeve paraqitet në mënyrë tabelare si më poshtë:

Emertimi	Plan Fillestar	Perdorimi	Teprica	
VKB nr. 172 datë 21.12.2020	Fondi Rezervë	150,000,000	11,653,500	138,346,500
	Kontigjenca	50,000,000		50,000,000
VKB nr. 75 datë 09.06.2021	'Për dhënien e ndihmës financiare, nga Bashkia e Tiranës për komunën e Preshevës, me qëllim lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet masive'		6,153,500	
VKB nr.96 datë 02.08.2021	'Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Galerisë së Artit, Tiranë'		5,500,000	
	Shuma	200,000,000	11,653,500	188,346,500

Fondi i Kontigjencës, NUK është përdorur gjatë kësaj periudhe.

✓ Fondi i Shpenzimeve të personelit për vitin 2021 është në vlerën 6,544,685,832 lekë dhe për periudhën 8-mujore 2021 realizimi është në masën 58 % të planit vjetor, Sikundër vihet re edhe në pasqyrën e mëposhtme nr. i faktik i punonjesve është 7423 punonjës. Më poshtë gjeni të dhëna të pasqyruara në mënyrë tabelare:

Emertimi	Nr. I punonjesve 2021 (plan)	Nr. I punonjesve 8-mujori 2021	Buxheti 2021	Fakti 8-mujori 2021	% Realizimit
<b>Total Aparati Bashkise</b>	2,376	2,292	2,367,605.716	1,414,457.562	60%
Agjensia e Mrojtjes se Konsumatoreve	188	186	174,571.700	104,904.689	60%
Drejtoria e Pergjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore	260	258	261,049.000	161,330.302	62%
Tirana Parking	115	112	110,640.200	62,365.945	56%
Drejtoria e Pergjithshme e Cerdheve dhe Kopshteve	1,801	1,751	1,457,205.779	793,408.883	54%
Agjensia e Parqeve dhe Rekreacionit	396	388	316,360.488	195,012.990	62%
Drejtoria e Pergjithshme e Pastrimit dhe Gjelberimit	550	550	391,085.340	236,640.635	61%
Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve dhe Ndricimit Publik	475	472	352,069.821	217,456.959	62%
Drejtoria e Pergjithshme e Objekteve Publike	845	845	629,472.418	347,231.432	55%
Qendra Kulturore Tirana	60	58	49,005.300	29,124.498	59%
Klubi Sportiv Tirana	39	39	33,579.900	17,109.669	51%
Qendra 'Te qendrojme se bashku'	27	25	23,689.600	12,943.445	55%
Qendra Multidisiplinare	26	26	23,237.100	12,315.071	53%
Qendra Komunitare ' Gonxhe Bojaxhi'	26	26	22,508.600	13,370.901	59%
Qendra Sociale Multidisiplinare 'Shkoze'	26	26	23,128.600	13,781.859	60%
Qendra Sociale "Streheza Tirane"	12	11	12,005.300	5,303.398	44%
Qendra Komunitare e Terrenit	20	19	19,262.400	11,253.812	58%
Agjencia e Admkinistrimit te Tregjeve	36	36	33,836.800	20,619.834	61%
Agjencia e Sherbimeve Funerale	132	130	84,872.172	46,859.465	55%
Drejtoria e Konvikteve	113	113	95,725.967	50,903.935	53%
Klubi Sportiv 'Studenti'	18	18	19,086.881	9,053.679	47%
Klubi Sportiv Shumesportesh 'Partizani'	10	10	10,411.950	5,321.034	51%
Muzeu Vendorsr "Shtepia Studio Kadare"	6	6	5,790.500	3,489.981	60%
Qendra e restaurimit dhe realizimit te veprave te artit 'Tirana'	7	7	6,687.100	4,125.612	62%
Agjencia e Rinise	13	13	13,297.200	7,180.032	54%
Muzeu vendor 'Shtepia studio Agolli'	6	6	5,000.000	1,925.097	39%
Galeria e Artit Tirane	12	-	3,500.000	-	-
<b>TOTALI</b>	<b>7,595</b>	<b>7,423</b>	<b>6,544,685.832</b>	<b>3,797,490.719</b>	<b>58%</b>
te kushtezuara (gj.c + qkb)	68	68	55,622.000	36,100.752	65%
te kushtezuara (KQZ)			32,832.000	27,351.300	83%
<b>TOTALI</b>	<b>68</b>	<b>68</b>	<b>88,454.000</b>	<b>63,452.052</b>	<b>72%</b>

# PJESA II

## Monitorimi i Shpenzimeve dhe Produkteve sipas programeve

### 1. Programi “Planifikim, Menaxhim & Administrim”


Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin e vitit 2021, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 67%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e Personelit 92%
- Shpenzime të tjera operative 54%
- Shpenzime kapitale 26%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2021	Plani 8-M 2021	Fakti 8-M 2021	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	1,631,512,195	1,075,539,763	985,089,865	92%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	1,521,405,389	1,163,601,025	625,448,991	54%
<i>Shpenzime kapitale</i>	271,940,354	252,384,296	64,864,319	26%
<b>Totali</b>	<b>3,424,857,938</b>	<b>2,491,525,084</b>	<b>1,675,403,175</b>	<b>67%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për vitin 2021 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Projekti “Sherbime te integruara sigurie per godinat, ne institucionet e arsimit parashkollor e shkollor dhe institucione te tjera te Bashkise Tirane”, janë planifikuar 228,567,296 leke per vitin 2021 dhe eshte realizuar 85,411,440 leke ose 86% të planit 8-mujor.
- ✓ Projekti ‘Programi Reload’, janë planifikuar 4,856,285 leke per vitin 2021 dhe eshte realizuar 3,788,000 leke, ose ne masen 78% te planit.
- ✓ Projekti “Fillo me nje ide, fito nje praktike pune ne BT" janë planifikuar 2,500,000 leke per vitin 2021 dhe eshte realizuar 1,813,409 leke, ose 36 % të planit.
- ✓ Projekti ‘Marrje mjetesh rrugore me qera operationale (leasing) për Bashkinë Tiranë’, janë planifikuar 93,542,400 leke per vitin 2021 dhe eshte realizuar 23,385,600 leke, ose ne masen 25% te planit.
- ✓ Projekti “Subvencionimi i lidhjes se kontratave dhe te vendosjes se matesave te ujit per kategorie ne nevoje’, janë planifikuar 5,000,000 leke per vitin 2021 dhe eshte realizuar 3,167,748 leke, ose 63% të planit.
- ✓ Projekti "Apps Challenge-Tirana" janë planifikuar 3,192,000 leke per vitin 2021 dhe eshte realizuar 1,243,248 leke, ose ne masen 39% te planit.
- ✓ Projekti "Panairi Punes" janë planifikuar 895,000 leke per vitin 2021 dhe eshte realizuar 270,000 leke, ose ne masen 30 % te planit.
- ✓ Detyrime gjyqesore, janë planifikuar 310,000,000 leke per vitin 2021 eshte realizuar 145,257,869 leke, ose 64 % të planit 8-mujor.
- ✓ Investimet për programin e Planifikim Menaxhim Administrim per vitin 2021 janë rreth 23 projekte / investime (ndertim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim projektim; softëare, hardëare, mirembajtje; te tjera) qe menaxhohen nga Aparati i Bashkise që mbulon këtë funksion.

## **2. Programi “Ceshtje Financiare & Fiskale”**


Në këtë program bën pjesë - Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin e vitit 2021, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 82%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e Personelit 96%
- Shpenzime të tjera operative 93%
- Shpenzime kapitale 0%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2021	Plani 8-M 2021	Fakti 8-M 2021	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	261,049,000	168,688,000	161,330,302	96%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	50,312,000	34,312,000	31,823,780	93%
<i>Shpenzime kapitale</i>	31,790,000	31,790,000	-	0%
<b>Totali</b>	<b>343,151,000</b>	<b>234,790,000</b>	<b>193,154,082</b>	<b>82%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për vitin 2021 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Investimet për programin ‘Ceshtje Financiare & Fiskale per vitin 2021 janë 4 projekte / investime qe menaxhohen nga Institucioni që mbulon këtë funksion.

### 3. Programi “Sherbimet e Policise Vendore”


Në këtë program bën pjesë - Aparati i Bashkisë,

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin e vitit 2021, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 92 %. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e Personelit 96%
- Shpenzime të tjera operative 62%
- Shpenzime kapitale 16%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2021	Plani 8-M 2021	Fakti 8-M 2021	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	479,877,501	313,633,201	301,381,295	96%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	34,377,799	34,377,799	21,398,461	62%
<i>Shpenzime kapitale</i>	3,420,000	3,420,000	558,000	16%
<b>Totali</b>	<b>517,675,300</b>	<b>351,431,000</b>	<b>323,337,756</b>	<b>92%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për vitin 2021 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Investimet për programin e Shërbimet e Policisë Vendore për vitin 2021 janë 4 projekte / investime që menaxhohen nga Institucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 3,420,000 leke për vitin 2021, të cilat janë realizuar 16% gjatë periudhës që raportojmë.

#### 4. Programi “Mbrotjtja nga Zjarri & Mbrotjtja Civile”

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë për Mbrotjtjen nga Zjarri dhe Emergjencën Civile.

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin e vitit 2021, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 33%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:


- Shpenzimet e Personelit 63%
- Shpenzime të tjera operative 33%



- Shpenzime kapitale 12%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2021	Plani 8-M 2021	Fakti 8-M 2021	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	175,725,987	142,220,013	89,881,152	63%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	2,668,404,379	2,563,163,827	850,106,753	33%
<i>Shpenzime kapitale</i>	216,505,807	190,857,826	23,127,106	12%
<b>Totali</b>	<b>3,060,636,173</b>	<b>2,896,241,666</b>	<b>963,115,011</b>	<b>33%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për vitin 2021 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- ✓ Projekti “Rikonstruksion i njësisve individuale të banimit dhe njësisve të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Tiranë”, janë planifikuar 563,640,000 leke per vitin 2021 dhe është realizuar 509,705,000 leke, ose ne masen 90% te planit.
- ✓ Projekti “Rindërtim i banesave individuale në Bashkinë Tiranë”, janë planifikuar 1,009,040,322 leke per vitin 2021 dhe është realizuar 236,545,112 leke, ose në masën 23% të planit.
- ✓ Projekti “Inspektim dhe Vleresim I thelluar I demeve ne Bashkine Tirane te prekura nga fatkeqesia natyrore e termetit te dates 26.11.2019”, janë planifikuar 61,835,368 leke per vitin 2021 dhe është realizuar 18,660,000 leke, ose ne masen 30% te planit.
- ✓ Projekti “Hartim i projekteve te nderhyrjeve rehabilituese/pershtatese te nevojshme per kthimin e struktures se objekteve qe jane klasifikuar si objekte me demtime te medha struktorore ose demtime shume te renda jostrukturore, në Bashkinë Tiranë”, janë planifikuar 87,358,750 leke per vitin 2021 dhe është realizuar 32,069,000 leke, ose ne masen 37% te planit.

- ✓ Projekti “Demolim dhe evadim i mbetjeve ndertimore, në Bashkinë Tiranë”, janë planifikuar 72,000,000 leke per vitin 2021 dhe është realizuar 26,248,660 leke, ose në masën 37% të planit.
- ✓ Investimet për programin e Mbrojtjes Nga Zjarri dhe Mbrojtjes Civile per vitin 2021 perbehet nga 8 projekte / investime të Emergences Civile dhe 5 projekte/investime të Mbrojtjes nga Zjarri qe menaxhohen nga Insitucionet që mbulojne këtë funksion.


## 5. Programi “Mbështetja per Zhvillimin Ekonomik”

Në këtë program bën pjesë - Aparati i Bashkisë,

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin e vitit 2021, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 60%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2021	Plani 8-M 2021	Fakti 8-M 2021	Realizimi ne %
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	73,000,000	69,000,000	41,369,609	60%
<b><i>Totali</i></b>	<b>73,000,000</b>	<b>69,000,000</b>	<b>41,369,609</b>	<b>60%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për programin ‘Mbështetja per Zhvillimin Ekonomik’ shpenzimet korente per vitin 2021 janë 4 projekte. Buxheti i planifikuar per kete program është 73,000,000 leke per vitin 2021.

- ✓ Projekti “Shërbime konsulence në hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për projektin TEDA”, janë planifikuar 35,000,000 leke per vitin 2021 dhe është realizuar 32,021,580 leke, ose në masën 92% të planit.
- ✓ Projekti “Organizata jo-fitimprurese TID”, janë planifikuar 20,000,000 leke per vitin 2021 dhe është realizuar 3,519,149 leke, ose në masën 18% të planit.
- ✓ Projekti “Mbështetje financiare(Grant) për biznese të reja"të gjelbërta të cilat bazohen në një model eko-miqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese "të gjelbërta" duke futur elementë go-green në to”, janë planifikuar 12,000,000 leke per vitin 2021 dhe është realizuar 5,828,880 leke, ose në masën 73% të planit 8 mujor.

## 6. Programi “Sherbimi i Tregjeve, Akreditimi & Inspektimi”


Ky program është në mbështetje të zhvillimit dhe mirëmbajtjes së funksionimit të tregjeve në territorin e Bashkisë Tiranë dhe menaxhohet nga Agjencia e Administrimit të Tregjeve me burim nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës.

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin e vitit 2021, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 82%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e Personelit 93%
- Shpenzime të tjera operative 86%
- Shpenzime kapitale 48%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2021	Plani 8-M 2021	Fakti 8-M 2021	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	33,836,800	22,076,000	20,619,834	93%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	32,000,000	21,600,000	18,512,441	86%
